



Statuti i Organizatës – Institutit Demokratik i Kosovës (KDI)

Shtator 2014

Ky statut do të qeverisë shoqatën jo-përfituese Kosova Demokratik Institute të themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-057Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.



Neni 1

1.1. Organizata do të quhet Kosova Democratic Institute.

1.2. Akronimi zyrtar i organizatës do të jetë KDI.

1.3. Organizata është shoqatë jo përfituese, sipas përkufizimit të dhënë në nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-057 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

1.4. Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo fitimi neto ose të profitit si të tillë për asnjë individ. Pasuria, të ardhurat dhe profiti i organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jo-përfituese të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësin, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesat e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona kanë bërë për këtë organizatë.

1.5. Ndonjë transaksion në mes të anëtarëve, personi ose nëpunësi dhe organizatës duhet të mbyllet në vlera reale të tregut ose në kushte që janë më të favorshme për organizatën.

1.6. Organizata e ka selinë e saj kryesore në Prishtinë, Republika e Kosovës. Adresa e organizatës është: Bajram Kelmendi, #38, Prishtinë, Kosovë me numër telefoni +381 (0)38 248 038.

Neni 2

2.1. Themelues të organizatës janë:

Arianit Shehu, Rr : Xhavit Ahmeti, #124, Prishtinë, Kosovë

Violetë Zeka, Rr : Ismajl Qemajli, #42, Arbëri, Prishtinë, Kosovë

Edita Mustafa, Rr: Vëllezërit Gërvalla, Prelez, pn, Ferizaj, Kosovë

2.2. Përfaqësues i autorizuar i organizatës është Drejtori Ekzekutiv, Ismet Kryeziu, me adresën postare dhe si në nenin 1.6 dhe numër telefoni +381 (0)38 248 038.

2.3. Drejtori ekzekutiv emërohet nga Bordi dhe duhet të përfaqësojë organizatën në Kosovë dhe jashtë Kosove si dhe të pranojë të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës. Ai duhet të jetë përgjegjës për informimin e autoriteteve relevante administrative për çfarëdo ndryshimi në organizatë.

Neni 3 – Qëllimi dhe vizioni

3.1. Qëllimi i KDI-së është të përkrahë zhvillimin e demokracisë përmes pjesëmarrjes së qytetarëve dhe fuqizimit të sektorit të shoqërisë civile në fushën e bërjes së politikave, transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë e institucioneve publike. Vizioni i KDI-së është që të ndërtojë një demokraci të konsoliduar me vlera të një shoqërie më të hapur dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve.

3.2. Për të përmbushur misionin e saj, organizata ka objektivat e poshtë shënuara:

- Avancim të praktikave parlamentare për një Kuvend më përfaqësues, transparent dhe llogaridhënës.
- Përmirësim të praktikave në promovim të transparencës dhe llogaridhënies si për nivelin qendror dhe atë lokal



- Hartim të politikave, legjislacionit dhe vendimeve me kontribut qytetar;
- Sigurim të integritetit dhe etikës së institucioneve në luftë kundër korrupsionit;
- Promovim të zgjedhjeve të lira dhe demokratike që garantojnë të drejta të barabarta dhe informim të votuesve;
- Mbështetje të organizatave lokale të shoqërisë civile përmes ndërtimit të kapaciteteve;
- Inkurajim të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në politikë-bërje;
- Promovim të barazisë gjinore në bërjen e politikave dhe marrjen e vendimeve në institucione publike dhe në shoqëri civile; dhe,
- Organizata ka të drejtë të hartojë dhe botojë punime dhe libra që kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të lartshënuara.

Neni 4 – Anëtarësimi

4.1. Anëtarësimi në organizatë është i hapur për çdo person pa marrë parasysh racën, gjininë, orientimin seksual, shtetësinë, kombësinë, religjionin, moshën ose aftësitë fizike.

4.2. Organizata nuk do të aplikoj masë të pagesës për anëtarët e organizatës.

4.3. Për tu bërë anëtar i organizatës personi duhet të bëjë një kërkesë me shkrim. Bordi i organizatës do të vendos me shumicë të votave për pranimin ose refuzimin e kërkesës për anëtarësim në organizatë.

4.4. Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimit nga Bordi do të vendoset me shumicë të anëtarëve prezent në mbledhjen e Bordit. Kërkesën për përfundim ose suspendim të anëtarësimit për ndonjë person mund ta kërkojë: Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori Ekzekutiv, anëtarët e Bordit ose 1/3 e anëtarëve të organizatës përmes një shkrese që i drejtohet Kryetarit/es të Bordit ku edhe specifikohen arsyet.

4.5. Anëtarësimi në organizatë i përfundon personit në mënyrë automatike nëse ai ose ajo dënohen nga Gjykata për vepër penale ose shkelin Kodin e Mirësjelljes, dhe nëse mungon në tri mbledhje të rregullta të Kuvendit të anëtarëve.

Neni 5- Kuvendi i Anëtarëve

5.1. Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës dhe përbëhet prej të gjithë anëtarëve të organizatës.

5.2. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës.

5.3. Kuvendi i Anëtarëve ka këto kompetenca: të zgjedh anëtarët e Bordit, të aprovoj raportin vjetor financiar dhe atë të punës, të aprovoj përvetësimin e pasurisë mbi vlerën e caktuar si dhe të aprovoj akte të tjera që konsiderohen të nevojshme për funksionimin e organizatës.

5.4. Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij në Bordin e organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij.

5.5. Kuvendi i Anëtarëve zgjedh nga radhët e veta njërin prej anëtarëve që të kryej punët e Kryesuesit të Kuvendit të Anëtarëve. Mandati i Kryesuesit është katër vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat të dytë.



5.6. Kandidatët për Kryesues të Kuvendit të Anëtarëve propozohen nga anëtarët e kuvendit dhe votohet nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të Kuvendit. Kryesuesi shkarkohet me shumicën e thjeshtë të votave të Kuvendit të Anëtarëve. Shkarkimi i Kryesuesit mund të kërkohet për arsyeje të: shkeljes së statutit, kodit të mirësjelljes ose nëse Gjykata e ka dënuar për veprë penale, sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë. 1/3 e anëtarëve të Kuvendit mund të kërkojnë shkarkimin e Kryesuesit.

5.7. Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve kujdeset për mbledhjet vjetore të përgjithshme dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Anëtarëve.

5.8. Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve duhet të jetë anëtarë i organizatës, të jetë i pavarur politikisht, i dëshmuar për promovimin e vlerave demokratike dhe avancimin e shoqërisë civile.

5.9. Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve nuk mund të jetë zyrtar, punonjës i organizatës apo pjesë e Bordit të organizatës.

5.10. Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve nuk mund të jetë zyrtarë apo punonjës i institucioneve qeveritare apo pjesë e strukturave udhëheqëse të partive politike.

Neni 6 - Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve

6.1. Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve thirren dhe kryesohen nga Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve. Nëse Kryesuesi nuk është në gjendje të kryej këtë obligim atëherë ai/ajo autorizojnë një anëtar të Kuvendit të kryej këto përgjegjësi.

6.2. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku dy herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet, e detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.

6.3. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga 1/3 e anëtarëve.

6.4. Lajmërimi me shkrim për MPV ose MPJ duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për takimin do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku shtatë ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.

6.5. Për mbajtjen e mbledhjes është e nevojshme pjesëmarrja e shumicës së thjeshtë të anëtarëve. Nëse kjo shumicë nuk arrihet takimi do të shtyhet për një ditë tjetër. Lajmërimi për takimin e ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve.

6.6. Secili anëtar i organizatës ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.

6.7. Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve të organizatës.

6.8. Secili anëtar i Kuvendit të Anëtarëve duhet të abstenojë nga votimi ose marrja e vendimit në çështje për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.



Neni 7 – Zgjedhja, mandati dhe kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

7.1 Zgjedhja dhe mandati i drejtorit ekzekutiv

7.1.1 Drejtori Ekzekutiv zgjidhet për mandat katër vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

7.1.2 Secili anëtar ka të drejtë të kandidojë nëse ai/a jo është anëtar i organizatës si dhe ka së paku (2) dy vite përvojë pune në kuadër të stafit të organizatës.

7.1.3 Zgjedhjet për Drejtor Ekzekutiv organizohen nga Bordi i organizatës i/e cili/a njofton të gjithë anëtarët e organizatës për datën e zgjedhjeve për Drejtor Ekzekutiv dhe fton të interesuarit të kandidojnë. Kryetari/ja cakton një periudhë deri kur do të pranohen kërkesat për kandidim për Drejtor Ekzekutiv. Kjo periudhë nuk mund të jetë më e shkurtër se (7) shtatë ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit.

7.1.4 Kandidatët për Drejtor Ekzekutiv dërgojnë aplikimin tek kryetari/ja e Bordit për të garuar për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv. Aplikimi duhet të përmbajë këto informacione: Emri dhe mbiemri, numri personal, datën dhe vendin e lindjes, periudha e angazhimit në KDI, një biografi të shkurtër si dhe një letër motivuese për kandidaturën e tij.

7.1.5 Pasi përfundon afati për paraqitjen e kërkesave për të kandiduar për postin e Drejtorit Ekzekutiv, Kryetari/ja i Bordit verifikon kërkesat se kanë plotësuar kushtet përkatëse sipas nenit 8.5 dhe pas përfundimit të verifikimit Kryetari/ja i Bordit dërgon një njoftim tek të gjithë anëtarët e Bordit për t'i njoftuar me kandidatët për postin e Drejtorit Ekzekutiv si dhe fton anëtar e Bordit për të marr pjesë në datën e votimit për zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv.

7.1.6 Zgjedhjet për Drejtorin Ekzekutiv mund të zhvillohen edhe me një kandidat. Në rastet e tilla kur kemi vetëm një kandidat dhe kandidati nuk merr shumicën e votave për zgjedhje atëherë Drejtori Ekzekutiv ekzistues vazhdon mandatin deri në organizimin e zgjedhjeve të ardhshme të cilat duhet të ndodhin më së largu pas 30 ditëve.

7.1.7 Kryetari i Bordit nënshkruan proces-verbalin e votimit duke shpallur edhe Drejtorin Ekzekutiv.

7.1.8 Drejtori Ekzekutiv nuk mund të jetë personi që kërkohet nga organet e rendit ose ka kryer ndonjë vepër penale për të cilën është shpallur fajtor me aktgjykim të plotfuqishëm, sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

7.1.9 Drejtori Ekzekutiv nuk mund të jetë anëtarë i Bordit të organizatës, zyrtar apo punonjës i institucioneve qeveritare apo pjesë e subjekteve politike.

7.2 Kompetencat, dhe Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv:

7.2.1 Organizimin e punës, menaxhimin e përgjithshëm të organizatës si dhe është përgjegjës për punësimin në organizatë, të nënshkruaj marrëveshje në dobi të organizatës.

7.2.2 Të emëroj dhe zgjedh përfaqësuesit, t'i përcaktoj kompetencat dhe detyrat e tyre.

7.2.3 Drejtori Ekzekutiv prezanton Raportin Vjetor, Financiar dhe të Punës së organizatës për konfirmim në Bordin e organizatës dhe pastaj për aprovimin final në Kuvendin e Anëtarëve.



7.3 Përfundimi i mandatit të Drejtorit Ekzekutiv

7.3.1 Shkarkimi ose suspendimi i mandatit të Drejtorit Ekzekutiv nga Bordi do të vendoset me 2/3 të anëtarëve të Bordit në mbledhjen e Bordit.

7.3.2 Shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv mund të kërkohet për arsyeje të: shkeljes së statutit, kodit të mirësjelljes ose nëse Gjykata e ka dënuar për vepër penale.

Neni 8 – Bordi, Zgjedhja e anëtarëve të Bordit dhe mandati i tyre

8.1 Bordi i KDI zgjidhet nga Kuvendi i Anëtarëve, me shumicë votash, dhe përbëhet nga së paku 3 anëtarë e më së shumti 7 anëtarë.

8.2 Mandati i anëtarëve të Bordit të KDI është katër(4) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje .

8.3 Mandati i anëtarëve të Bordit nuk fillon dhe nuk përfundon në kohën e njëjtë, 1/2 e anëtarëve ripërtërihet çdo dy (2) vite.

8.4 Zgjedhja, Ndryshimi dhe plotësimi i anëtarëve të Bordit të KDI-së nuk mund të bëhet për më shumë se ½ e anëtarëve të Bordit në të njëjtën kohë .

8.5 Anëtarët e Bordit të KDI duhet të jenë anëtarë të organizatës, të jenë të pavarur politikisht, të dëshmuar për promovimin e vlerave demokratike dhe avancimin e shoqërisë civile.

8.6 Propozimin për anëtarë të Bordit të KDI mund ta bëjnë së paku 1/3 e anëtarëve të organizatës, anëtarët e Bordit, ose drejtori ekzekutiv.

8.7 Bordi i KDI-së përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me statutin e KDI-së.

8.8 Mandati i anëtarit të Bordit të KDI përfundon:

8.8.1 Në rast të dorëheqjes vullnetare, apo në rastin e vdekjes së tij/saj;

8.8.2 Në rast të shkeljes së rëndë të detyrave dhe përgjegjësive të tij/saj si anëtar i Bordit të KDI, me vendim të Kuvendit të Anëtarëve, sipas të njëjtës procedurë që është zgjedhur;

8.8.3 Në mospjesëmarrjes në takimet e Bordit të KDI për tre mbledhje me radhë.

8.8.4 Në rast se dënohet për kryerjen e ndonjë vepre penale, sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

8.9 Takimet e Bordit

8.9.1 Bordi do të zgjedhë për Kryetar njërin nga anëtarët e tij, me mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhje të njëpasnjëshme.

8.9.2 Kryetari i Bordit duhet të thërras takime të Bordit sipas nevojës, por të paktën dy (2) herë brenda një viti. Bordi duhet të pajtohet për një orar të përkohshëm të takimeve të paktën dy javë para takimit. Materialet



për takim duhet të dërgohen të të gjithë anëtarët e Bordit, të paktën një javë para takimit, nga Kryetari i Bordit, ose Drejtori Ekzekutiv.

8.9.3 Takimet e Bordit mund të thirren gjithashtu edhe nga të paktën tre (3) anëtarë të Bordit.

8.9.4 Në takimet e Bordit, përveç anëtarëve të Bordit merr pjesë edhe Drejtori Ekzekutiv. Sipas nevojës, Kryetari i Bordit ose të paktën tre (3) anëtarë mund të ftojnë në takim edhe persona tjerë prania e të cilëve konsiderohet e domosdoshme për mbarëvajtjen e takimit.

8.9.5 Drejtori Ekzekutiv, ose një nga punëtorët e administratës së KDI, mbajnë procesverbalin e takimit, i cili i shpërndahet anëtarëve të Bordit jo më vonë se një (1) javë pas takimit, dhe i cili nënshkruhet nga Kryetari i Bordit jo më vonë se në takimin e radhës, pas aprovimit nga Bordi.

8.9.6 Shumica e anëtarëve të Bordit do të përbëjnë kuorumin. Nëse nuk ka kuorum, mbledhja do të shtyhet për ditën e caktuar, por jo më vonë se dy (2) javë pas datës fillestare të paraparë për takim, dhe njoftimi do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve paraprakisht.

8.10 Kompetencat

8.10.1 Emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të KDI dhe përcaktimin e detyrave të tij/saj;

8.10.2 Aprovimin fillestar të planit të punës, planifikimit vjetor buxhetor, raporteve narrative dhe atyre financiare, dhe propozimin e tyre në Kuvend;

8.10.3 Përfaqësimin e KDI me palë të treta dhe diskutimet e marrëveshjeve potenciale të KDI me këto palë;

8.10.4 Pranimin e anëtarëve të rinj të KDI, pas vlerësimit që i plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara me Statut;

8.10.5 Përcaktimin e datës së mbajtjes së Kuvendit dhe rendit të ditës, pas konsultimit me drejtorin ekzekutiv dhe kryesuesin e kuvendit të KDI

8.10.6 Propozimin e ndryshimeve në Statut, Kod Etik, Rregullore të Punës, Rregullore të Bordit apo dokumente tjera të KDI të cilat duhet të aprovohen nga Kuvendi;

8.10.7 Emërimin e këshillave sektoriale të përhershme ose grupeve punuese të përkohshme dhe përcaktimin e mandatit dhe kompetencave të tyre.

8.10.8 Diskutimin e të gjitha çështjeve tjera me rëndësi për KDI.

8.11 Vendim-Marrja

8.11.1 Vendimet e Bordit synohen të merren me konsensus. Në rastet e mospajtimit ose në rastet specifike, vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit. Në rast të rezultatit të barabartë të votimit, Kryetari i Bordit do të ketë votën vendimtare. Vendimet e Bordit janë të vlefshme nëse janë të pranishëm shumica e thjeshtë e anëtarëve të Bordit.



8.11.2 Secili anëtar i Bordit duhet të përmbahet nga votimi në të gjitha rastet kur ai/ajo ose organizata anëtar/e i/e së cilës është ka interes ekonomik. Secili anëtar i Bordit duhet që paraprakisht të deklarojë konfliktin e interesit për çështjen e cila diskutohet dhe e cila hidhet në votim.

8.12 Gjuha e punës

8.12.1 Gjuha e punës së Bordit është gjuha shqipe, ndërsa sipas nevojës mund të përdoret edhe ajo serbe apo angleze.

8.13 Kompensimi

8.13.1 Në parim, puna e anëtarëve të Bordit të KDI do të bëhet në mënyrë vullnetare.

8.13.2 Përrjashtimisht nga neni 8.13.1, me vendim të posaçëm të Bordit, anëtarët e Bordit do të kompensohen me një mëditje të caktuar për mbledhjet e bordit ose në rastet kur një angazhim shtesë i veçantë kërkohet nga ndonjë anëtar i Bordit, dhe vetëm pasi që Bordi të ketë ardhur në përfundim që ky angazhim është i domosdoshëm dhe bëhet në kushtet më të favorshme për KDI.

8.13.3 Përrjashtimisht nga neni 8.13.1. dhe neni 8.13.2 kompensimi I anëtarëve të bordit bëhet vetëm në rastet kur KDI posedon me fonde të mjaftueshme për këtë pagesë.

Neni 9 – Zyrtarët dhe Nëpunësit

9.1 Në rast nevojë Drejtori Ekzekutiv ose Menaxherët e Programeve do të punësojnë përmes institucionit të konkursit ose të emërojnë drejtpërdrejt zyrtarë ose të pranojnë persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të organizatës. Kohëzgjatja e punësimit të tyre duhet të caktohet përmes Kontratës nga Drejtori Ekzekutiv ose Menaxherët e Programeve.

9.2 Zyrtarët duhet të punësohen përmes kontratave të shkruara të cila detajizojnë të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet tu paguhen këtyre zyrtarëve. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer në organizatë. Marrëveshjet e punës, kontratat dhe të gjitha marrëveshjet e tjera nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutiv ose Menaxherët e Programeve.

Neni 10 – Shpërbërja e Organizatës

10.1. Organizata mund të shpërbëhet me vendimin e 2/3 të votave të Kuvendit të Anëtarëve.

10.2. Në rast të shpërbërjes së organizatës asetet, arkiva/dokumentacioni si dhe sendet e luajtshme nuk mund të trashëgohen nga Anëtarët e Organizatës dhe as nga Anëtarët e Bordit, por këto asete dhe sende duhet të dhurohen në ndonjë shoqatë jo-fitimprurëse apo fondacione.

10.3. Kur të vendoset për shpërbërjen e organizatës, kuvendi i anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jetë liruar nga detyrimet e organizatës. Shoqata apo fondacioni i zgjedhura duhet të kenë qëllime të njëjta ose të ngjashme sikurse organizata.

10.4. Gjithashtu organizata e cila do të trashëgoj pasurinë e organizatës do të trashëgoj edhe arkivin dhe dokumentacionin e organizatës përveç nëse ndryshe rregullohet me legjislacionin e Republikës së Kosovës.



Neni 11 – Ndryshimi i Statutit

11.1. Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e dy të tretave të votave të Kuvendit të Anëtarëve.

Neni 12 – Periudha e Raportimit dhe Viti Financiar

12.1 Drejtori Ekzekutiv paraqet raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve, MPV ose kurdoherë që kërkohet nga një MPJ.

12.2 Viti financiar i organizatës përputhet me vitin kalendarik.

Neni 13 - Dispozitat Tjera

13.1 Ky statut hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Kuvendi i Anëtarëve me datë 27 shtator 2014 në Prishtinë.

Nga Anëtarët e Kuvendit: